



LENDA -KIMI

Njesia mesimore

ACIDET

Pergaditi Prof. Hafsa Selimi

ACIDET

Acidi është komponim kimik, zakonisht i lëngshëm, me shije të thartë e veti gërryese, që përmban hidrogjen dhe që në reaksion me metalet jep kripëra. Varësisht nga bashkimi kimik dallohen edhe acidet, ndër më të njohurit janë Acidi sulfurik, Acidi yndyror apo Acidi organikë. Gjithashtu kemi hidroacide dhe oksiacide. Acidet ne uje rrisin përqendrimin e joneve të hidrogjenit.

Acidet që në përbërjen e tyre kanë atome të oksigjenit quhen acide oksigjenike, kurse ato që nuk kanë atome të oksigjenit quhen acide jooksigjenike.



Emërtimi i acideve (Nomenklatura)

Emërtimi i acideve jooksigjenike bëhet ashtu që emrit të jometalit që e krijon acidin i shtohet prapashtesa "hidrik". Keto acide quhen ndryshe acide hidrike, për shkak të përmbajtjes së Hidrogjenit në fillim të çdo formule. Për shembull:

HCl - acidi klorhidrik

H₂J - acidi jodhidrik


Emërtimi i acideve oksigjenike bëhet në këtë mënyrë: emërtimi i acidit kryesor (themelor) bëhet ashtu që emrit të elementit që e krijon acidin i shtohet prapashtesa "ik".

Acidet marrin pjesë në përbërjen e organizmit të njeriut, burimi kryesor i tyre janë proteinat ushqimore, të cilat përmbajnë grupe sulfate dhe fosfate, prej të cilave me proceset metabolike krijohen acidet dhe . Ngarkesa ditore e organizmit me acidet e krijuara në këtë mënyrë është 150 .¹¹



ACIDET KARBOSIKLIKE

- Acidet karboksilike janë komponime organike, të cilat në molekulat e tyre përmbajnë grupin funksionar karboksilik (-COOH) të lidhur për radikal alkilik ose aromatik. Formula e përgjithshme e acideve karboksilike aciklike është R-COOH, ndërsa për acidet aromatike, Ar-COOH. Grupi funksionar karboksil përbëhet prej grupit karbonil $>C=O$ dhe grupit hidroksil -OH.



Acidet e përditshme

Limonët, qitrot dhe uthulla kanë shije të thartë. Pse? Ato të gjitha përmbajnë acide. Acidet janë thelbësore për jetën. Acidi klorhidrik në stomakun tuaj ndihmon në tretjen e ushqimit. Acidi askorbik, vitamina C te frutat e mban lëkurën tuaj të shëndetshme dhe ndihmon për formimin e kockave. Ju keni nevojë për acidet lyrore omega-3 nga vaji I peshkut ose nga soja, për ta ndihmuar trupin tuaj të mbrohet ndaj sëmundjeve. Acidet kanë shumë përdorime. Uthulla është një tretësirë e acidit etanoik me ujë. Ajo përdoret për të ruajtur frutat dhe perimet në formën e turshive. Pijet e gazuara përmbajnë acide, për ti aromatizuar dhe për ti ruajtur. Acidet natyrore, gjithashtu mund të jenë edhe të bezdisshëm. Acidi metanoik I bën të dhimbshme pickimet e bletëve dhe milingonave. Acidet gjithashtu, e bëjnë djersën të vijë erë të rëndë .

Acidet laboratorike

Shpeshherë në shkollë ju përdorni acidet, sulfurik, klorhidrik dhe nitrik. Këta acide janë brejtës, edhe kur përzihen me shumë ujë. Kjo do të thotë se ata I shkatërrojnë indet e gjalla dhe mund t'ju djegin lëkurën dhe sytë. Ju duhet të vini syzet mbrojtëse kur përdorni acidet në laborator dhe të siguroheni që kqto acide të mos ju bien mbi Lëkurë. Acidi sulfuric është shumë I rëndësishëm. Ai përdoret për të peodhuar plehra kimike, detergjentë, ngyrues, mjekime, insecticide, bojëra dhe bateri. Në shkallë botërore, fabrikat prodhojnë mbi 180 milionë ton acid sulfuric çdo vit.

Emërtojmë acidet e mëposhtme :

HCl, HBr, H₂CO₃, H₂SO₄, HNO₂, HNO₃, H₃PO₄

HCl - acid klorhidrik - hidracid

HBr - acid bromhidrik - hidracid

H₂CO₄ - acid karbonik - oksiacid

H₂SO₄ - acid sulfuric - oksiacid

HNO₂ - acid nitror - oksiacid

HNO₃ - acid nitrik - oksiacid

H₃PO₄ - acid fosforik - oksiacid

Bazat

Bazat janë kimkate të kunderta me acidet. Ato shpesh japin ndjesinë se janë të rrëshqitshme gjatë prekjës, por ju nuk duhet ti prekni kurrë direkt me dorë, me përjashtim të rasteve kur ju është thënë se është e sigurt për ta bërë një gjë të tillë. Pasta e dhëmbëve dhe detergjenti larës I rrobave japin tretësira bazik. Tretësira e hidrokosit të natriumit është një bazë e rëndësishme. Ajo përdoret për të prodhuar letrën dhe detergjentët. Ajo, gjithashtu përdoret për të prodhuar metalin alumin. Shumë tretësira bazash janë tejet brejtëse. Një pikë e vogël e hidrokosit të natriumit, kur bie në lëkurë krijon një flluskë të pakëndshme. Nëse hidrokosi I natriumit ju futet në sy, ai mund tju shkaktojë verbim. Ju duhet ti vini gjithmonë syzet mbrojtëse, kur I përdorni bazat ose acidet në laborator.

Emërtojmë bazat : NaOH , KOH , $\text{Fe}(\text{OH})_2$, $\text{Cu}(\text{OH})_2$, $\text{Al}(\text{OH})_3$, $\text{Zn}(\text{OH})_2$, $\text{Mg}(\text{OH})_2$

NaOH - Hidrokosi natriumi

KOH - Hidrokosi kaliumi

$\text{Fe}(\text{OH})_2$ - Hidrokosi hekuri (II)

$\text{Cu}(\text{OH})_2$ - Hidrokosi bakri (II)

$\text{Al}(\text{OH})_3$ - Hidrokosi alumini

$\text{Zn}(\text{OH})_2$ - Hidrokosi zinku

$\text{Mg}(\text{OH})_2$ - Hidrokosi magnezi



Acidet dhe bazat e forta & të dobëta

